

situatë ka një impakt të jashtëzakonshëm mbi tregjet e të mirave afat-gjata të konsumatorit, por kjo do të ndikojë gjithashtu në kërkesën për produkte të paprekshme. Për shembull, ndërkohë që rritet numri i investitorëve të rinj që përdorin internetin për tregëtinë online, kjo do të çojë në një inkurajim të një tregu më eficient me ekzekutime të shpejta dhe më shumë besueshmëri në çmimet e titujve.¹²

- Një fond i përzier është përcaktuar nga një kompani e vetme trustesh për përdorimin e klientëve të bankës dhe nuk mund të përdoret në mënyrë ligjore nga njerëz jashtë marrëdhënies së përcaktuar të trustit. Për këtë arsye këto llogari ndryshojnë nga fondet e përbashkëta, të cilat janë krijuar për investitorët që duan të bashkohen të ardhurat e tyre. Ndërkohë që bankat punësojnë përfaqësues të regjistruar për të shitur jashtë fonde të përbashkëta publikut investues, fondet e përziera janë mjete të veçanta që zakonisht ofrohen sëbashku me shërbimet e departamentit të trusteve të bankës.¹³ Teknika e njohur si përzierje përfshin bashkimin e titujve për të krijuar një fond të një tipi të caktuar të klasifikimit të një titulli. Teknika e përzierjes aplikohet në të dyja sëbashku, fondet e përziera dhe fondet e zakonshme të trusteve. Në një kuptim më të jashtëm, ideja e përzierjes ose e bashkimit të titujve mund të krahasohet me konceptin e fondit të përbashkët. Në secilën prej tyre, pjesëmarrësit ndajnë në kthimin total të titujve që paguajnë dividend dhe që vlerësojnë në vlerë.

Bibliografia

- Alan Northcott, "The Complete Guide to Investing in Short Term Trading: How to Earn High Rates of Returns Safely", Atlantic Publishing Group, 2007.
- Guy Cohen, "Options Made Easy: Your Guide to Profitable Trading", Published by Pearson Education, 2013.
- Jason Kelly, "Neatest Little Guide to Stock Market Investing", Publishing by Penguin Group, 2013.
- John J Murphy, "Technical Analysis of the Financial Markets: A Comprehensive Guide to Trading Methods and Applications, New York Institute of Finance, 1999.
- Mark Douglas, "Trading in the Zone: Master the Market with Confidence, Discipline and a Winning Attitude Mark Douglas", 2001.
- Mark R. Conway and Aaron N. Behle, "Professional Stock Trading: System Design and Automation", Published by Acme Trader LLC, 2003.
- Tim Ord, "The Secret Science of Price and Volume: Techniques for spotting Market Trends, Hot Sectors, and the Best Stocks", Wiley Trading, 2008.
- http://en.wikipedia.org/wiki/Uniform_Gifts_to_Minors_Act

¹² Id.fq.68.

¹³ Mark Douglas, "Trading in the Zone: Master the Market with Confidence, Discipline and a Winning Attitude Mark Douglas", 2001, fq.15.

Kufizimet e pronësisë në median audiovizive

Prof.Asoc.Dr. Endirë Bushati

Prof.Dr. Migena Leskoviku

Abstrakti

Ka një lidhje të qartë mes konceptit të pluralizmit në media dhe konkurrencës. Kjo lidhje ngjall debate dhe keqkuptime të mëdha. Keqkuptimi kryesor qëndron në kundërshtinë mes ndërhyrjes ex ante dhe ndërhyrjes ex post, mes rregullimit dhe konkurrencës. Ndërhyrjet rregullatore shpesh mbrojnë konkurrencën dhe nga mbrojtja e konkurrencës, rregullohet tregu. Përmes kësaj mbrojtjeje të konkurrencës, pra, ekzistencës së shumë operatorëve, synohet shmangia e përqendrimit në sektorin audioviziv.

Kufizimet e pronësisë në median audiovizive, gjithmonë janë shoqëruar me debate të ashpra edhe në Shqipëri. Ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i miratuar me konsensusin e të gjitha palëve të politikës përse i përket përmbajtjes, ka rregulla të thjeshta e të qarta në këtë drejtim. Ky ligj, në raport me rregullimet ligjore të mëparshme, paraqet risi përse i përket kufizimit të pronësisë, duke rregulluar dhe të metat e vërejtura nga zbatimi në praktikë i ligjeve të mëparshme.

Fjalët kyçe: pluralizëm, media, kufizim, pronësi, licencë

Hyrje

Në Kushtetutën tonë e drejta e informimit është e garantuar¹. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i kushtohet lirisë së shprehjes, duke garantuar lirinë e shtypit, radios dhe televizionit. Në pikën 4 të këtij neni, parashikohet që, ligji

¹ Neni 23/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit. Edhe neni 10 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, parashikon që, liria e shprehjes e garantuar nga neni, nuk ndalon Shtetet që të kërkojnë licencim për televizion.

Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, të parashikuara nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, e deklaruar kjo në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton edhe garantimin e lirisë së shprehjes, të lirisë së shtypit dhe së drejtës së informimit, si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.

Parë në këndvështrimin e mësipërm, Gjykata jonë Kushtetuese i ka kushtuar vëmendje të posaçme lirisë së shprehjes, duke theksuar se: *“Në dallim nga KEDNJ-ja, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj. [...] Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelore të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efkase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efkas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore.”*²

Pas disa përpjekjesh ligjore e institucionale, 18 vjet pas daljes së ligjit të parë që synonte rregullimin e tregut mediatic audioviziv, ky treg në vendin tonë vazhdon të mbizotërohet nga informaliteti, moszbatimi i ligjit dhe situata monopol. Faktorët e një gjendjeje të tillë janë të shumtë, por lulëzimi i televizioneve private në kushtet e vakuimit ligjor, lidhja e mëpasshme klienteliste e televizioneve me partitë politike, një autoritet rregullator i dobët dhe shpesh nën presione të forta politike dhe nga operatorët, janë disa nga shkaqet kryesore të këtij informaliteti.

Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik, si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë, si formë e qeverisjes.

Pluralizmi në media është një koncept i gjerë. Vetë jurisprudenca e GJEDNJ është e qartë kur pohon “neni 10 i Konventës nuk i referohet vetëm të drejtës individuale të lirisë së medias, por imponon edhe detyrimin për të garantuar pluralizmin e opinionëve dhe diversitetin kulturor në interes të mirëfunksionimit të sistemit demokratik e lirisë për informim për të gjithë,... dhe për më tepër, pluralizmi është një rregull i përgjithshëm i politikës evropiane për median”³

² Vendimi Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³ Vendimi *Informationsverein Lentia vs. Austri*, 14 Nëntor 1993.

Po ashtu, GJEDNJ-ja në lidhje me lirinë e shprehjes ka theksuar: “Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i lirisë së shprehjes nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkojë të merren masa pozitive të mbrojtjes nëpërmjet ligjeve dhe praktikave të tij. Duke marrë parasysh rëndësinë e asaj çfarë garanton neni 10 i Konventës, shtetet duhet të jenë garantuesit e fundit të pluralizmit. [...] Gjykata konsideron se në fushën e transmetimeve audiovizuale, parimet e parashtruarai vendosin shtetit detyrimin për të garantuar, së pari, që publiku të ketë akses nëpërmjet TV-së dhe radio-s për një informacion të drejtë dhe të paanshëm dhe për një gamë opinionesh dhe komentesh, të cilat reflektojnë përmbajtjet e shumëllojshme politike brenda vendit dhe, së dyti, që gazetarët dhe profesionistët që punojnë në mediat audiovizuale të mos ndalohen për dhënien, shpërndarjen dhe përmbajtjen e këtij informacioni. Gjykata vëren se në një sektor të tillë sensitiv si ai i mediave audiovizuale, përveç detyrimit negativ për të mos ndërhyrë, shteti ka detyrimin pozitiv për të krijuar një kuadër legjislativ dhe administrativ për të garantuar pluralizmin efektiv.”⁴

Rekomandimi i Këshillit të Evropës i vitit 1999 mbi masat për të promovuar pluralizmin në media⁵ jep ca elementë të dobishëm për ta përkufizuar konceptin. Në mënyrë të veçantë, në Memorandumin sqarues, sqarohet që “Pluralizmi në media” kuptohet si ekzistenca e shumë mjeteve të komunikimit, e kuptuar si pluralitet media autonome dhe të pavarura (pluralizmi strukturor), si pluralitet llojesh komunikimi e përmbajtjes (mendime, opinione) që i bëhen të njohura publikut. Në aspektin politik, pluralizmi në media përfshin, nevojën e një numri të gjerë opinionesh politike që duhet të përfaqësohen në media për të garantuar demokracinë dhe për të shmangur krijimin e një mendimi dominues.

Po ashtu, standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me pronësinë në media i njohin “hapësirën e vlerësimit” shtetit përkatës, si në instrumentet me të cilat operojnë, ashtu edhe për mënyrën se si mund të arrijnë qëllimet dhe pikësynimet e interesit të përgjithshëm në nivel kombëtar. Rekomandimi i Këshillit të Ministrave CM/Rec (2007) 2 “Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike” thekson se *“në mënyrë që të mbrohen dhe promovohen aktivisht opinionet, shprehjet dhe idetë pluraliste, si dhe shumëllojshmëria kulturore, shtetet anëtare duhet të adoptojnë një kuadër ekzistues rregullator, veçanërisht në lidhje me pronësinë e mediave dhe të adaptojnë çdo masë financiare dhe rregullatore me qëllim që të garantojnë transparencën e medias dhe një pluralizëm struktural, si dhe një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të përcjella publikut”*.

Në Bashkimin Europian, nocioni i pluralizmit, si parim bazë parashikohet në Traktatin e Lisbonës, si një nga vlerat bazë të BE. Por, mungon si përkufizim

⁴ Vendimi *Europa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*, vendim i datës 7 qershor 2012, referuar edhe në Vendimin Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁵ Këshilli i Evropës, Rekomandim n.R (99) 1 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për masat për të promovuar pluralizmin në media, 19 janar 1999.

në zbatimin specifik në sektorin e komunikimit. Pluralizmi në media i “besohet” rregullimit të Shteteve anëtare. Gjithsesi, në thelb, përfshihet në konceptin e pluralizmit të pranuar nga Komisioni Evropian gjithçka që i garanton qytetarit aksesin në shumë burime informimi dhe që i mundësojnë krijimin e lirë të opinioneve. Garanci e pluralizmit, mbetet transmetuesi publik.

Ka një lidhje të qartë mes konceptit të pluralizmit në media dhe konkurrencës. Kjo lidhje ngjall debate dhe keqkuptime të mëdha. Keqkuptimi kryesor qëndron në kundërshtinë mes ndërhyrjes ex ante dhe ndërhyrjes ex post, mes rregullimit dhe konkurrencës. Ndërhyrjet rregullatore shpesh mbrojnë konkurrencën dhe nga mbrojtja e konkurrencës, rregullohet tregu.⁶ Përmes kësaj mbrojtjeje të konkurrencës, pra, ekzistencës së shumë operatorëve, synohet shmangia e përqendrimit në sektorin audioviziv.

Kufizimet e pronësisë në median audiovizive, gjithmonë janë shoqëruar me debate të ashpra edhe në Shqipëri. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar me konsensusin e të gjitha palëve të politikës përse i përket përmbajtjes, ka rregulla të thjeshta e të qarta në këtë drejtim. Ky ligj, unikal në historinë e parlamentarizmit shqiptar (përgatitja e tij zgjati 6 vjet), i asistuar me ekspertizën e KiE, OSBE, Komision Evropian, në raport me rregullimet ligjore të mëparshme, paraqet disa risi përse i përket kufizimit të pronësisë, duke rregulluar dhe të metat e vërejtura nga zbatimi në praktikë i ligjeve të mëparshme.

1. Rregullimi ligjor i pronësisë mbi median audiovizive gjatë viteve 1997-2013

1.1 Ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

Ligji i parë i miratuar për rregullimin e tregut të medias audiovizive ishte ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”. Lindja dhe veprimtaria e televizioneve dhe radiove të para private, e një tregu pa rregulla, solli domosdoshmërinë e një ligji të tillë edhe në kushtet e krijuara në vitin 1997.

Ligji 8221 e rregullon çështjen e pronësisë së radiove dhe televizioneve në nenin 19 të tij, kur trajton procesin e dhënies së licencës. Kufizimet e pronësisë shfaqen në 3 drejtime:

i. Kufizime në përqindjen e aksioneve në kapitalin e shoqërisë aksionare mbajtëse të licencës radiotelevizive dhe në një licencë të dytë radiotelevizive; ii. Kufizime specifike për personat me shtetësi të huaj; iii. Kufizime specifike në raport me subjektet që zotërojnë ndërmarrjet botuese të gazetave.

⁶ V. Franceschelli, E. Tosi, Diritto degli audiovisivi, Giuffrè Editore, Milano, 2012.

Sipas këtij rregullimi, licenca për radio dhe televizion u jepej vetëm shoqërive aksionare të krijuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto shoqëri aksionare duhet të kishin synim ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të kishte më shumë se 25% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë.

Personat me shtetësi të huaj nuk mund të ishin përfaqësues apo drejtues të shoqërisë që zotëron licencën radiotelevizive, as të kishin direkt apo indirekt më shumë se 20% të kapitalit apo të të drejtave të votës në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Përse i përket mundësisë për një licencë të dytë radiotelevizive nga një shoqëri që zotëron një licencë radiotelevizive, neni 19 përcaktonte: “...Një person fizik apo juridik që ka mbi 15% të kapitalit të një shoqërie radiotelevizive, nuk mund të ketë, direkt apo indirekt, më shumë se 15% të kapitalit në një shoqëri të dytë radiotelevizive. Pra, asnjë person fizik e juridik që mund të kishte deri në 25% të aksioneve në një shoqëri aksionare mbajtëse të një licence, nuk mund të kishte, direkt ose indirekt më shumë se 15% të kapitalit në një shoqëri të dytë radiotelevizive. Bie në sy paqartësia me të cilën është formuluar neni. Se cilat do të ishin rastet e zotërimit “indirekt” mbetet çështje interpretimi. Ndërkohë që neni nuk bën dallim të qartë mes radios dhe televizionit, duke u paraqitur mjaft kufizues në zotërimin e një licence radioje apo televizioni.

Ky nen paraqet një kufizim interesant përse i përket shtypit të shkruar. Ndalohej dhënia e licencës radiotelevizive personave juridikë e fizikë që zotërojnë kontrollin e ndërmarrjeve botuese të gazetave me tirazh që kalon 10% të tirazhit të përgjithshëm të gazetave në Shqipëri. Qëllimi i ligjvënësit në këtë drejtim ishte i qartë: synonte shmangien e përqendrimit në një numër të vogël “pronarësh” të medias, qoftë audiovizive, qoftë të shkruar.

Në dispozitat kalimtare të ligjit parashikohej që rregullimet për dhënien e licencave do të zbatoheshin 12 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Ndërkohë, radiot dhe televizionet private që deri në datën 14 maj 1997 ushtronin veprimtari të palicensuar sipas kërkesave të ligjit, mund të mos e ndërprisnin atë deri në datën 14 maj 1998. Përmes kësaj dispozite, ligjvënësi u dha kohë 1 vit subjekteve të palicensuara që ushtronin veprimtari radiotelevizive në atë kohë, që të licencoheshin dhe të rregullonin veprimtarinë e tyre sipas kërkesave të ligjit. Askush nuk e mendonte që informaliteti i tregut audioviziv do të vazhdonte deri në vitin 2015.

1.2 Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar disa herë, shfaqet si ligji më jetëgjatë për

rregullimin e tregut të medias. Shumë shpejt, ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, u shfaq i pazbatueshëm në praktikë, kjo edhe për shkak të fuqizimit e rritjes së presionit që pronarë të ndryshëm të televizioneve private ushtronin mbi pushtetin politik. Nevoja për t’iu përshtatur kushteve të reja të tregut dhe për korrigjuar e plotësuar mangësitë e ligjit të vitit 1997, solli domosdoshmërinë e miratimit të një ligji të ri. Ky ligj rregullonte veprimtarinë radiotelevizive që zhvillohej përmes transmetimeve analoge tokësore, kablllove, përsëritëve apo rrjeteve satelitore.

Ligji 8410/1998 parashikonte kufizimin e pronësisë në nenin 20, nen që përmbante dispozitat e përgjithshme për licencimin.

Sipas këtij neni, licencat ishin dy llojesh: kombëtare dhe vendore. Në varësi të licencës, neni jepte dhe kufizimet përkatëse. Përvec kufizimeve të parashikuara për rastet e licencave, ky nen parashikonte dhe ndalimin për personat me aksione në media, për të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit si dhe në proceset e privatizimit të pronës shtetërore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje në shkallë kombëtare u jepeshin shoqërive anonime që themeloheshin me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të kishte më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë. Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime, me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio, ishin të vlefshme kur në to merrnin pjesë jo më pak se dy të tretat e mbajtësve të aksioneve. Një person fizik ose juridik, që kishte aksione në një shoqëri televizive ose radioje kombëtare, nuk lejohet të ishte, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrës në një shoqëri të dytë televizive ose radioje kombëtare, si dhe nuk i lejohet të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje vendore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje vendore u jepeshin personave juridikë e fizikë të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Të njëjtit subjekt nuk i jepej licencë për më shumë se dy zona transmetimi vendor. Licenca për transmetim vendor në zonat urbane me mbi 200 000 banorë nuk u jepej personave fizikë. I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv vendor mund të merrte vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje vendor. I njëjti subjekt që zotëron një licencë për radioje vendore mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim televiziv vendor.

Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri radio ose televizive, nuk lejohet që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit, njësitë të pushtetit vendor ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe në procesin e privatizimit të pronës publike.

Për shkak të mosrregullimit të saktë ligjor, shumë shpejt në tregun mediatik audioviziv u shfaq fenomeni i aksioneve në emër të bashkëshortëve apo familjarë të afërt, duke shmangur në këtë mënyrë kufizimet në përqindje apo për licenca të dyta që parashikonte neni 20.

Licenca e transmetimit ishte e patjetërsueshme dhe vllente vetëm për subjektin të cilit i ishte dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hynte në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave ishte edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që buronin nga licenca kërkohej miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që kishte fituar këto të drejta, miratimi i jepej në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miratonte kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofronte frekuencat që i përkisnin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash.⁷

1.3 Ligji nr.9742, datë 28.5. 2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”

Ky ligj synonte rregullimin e transmetimeve numerike (digjitale), si në respekt të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si për “legalizimin” e operatorëve numerikë që lindën në Shqipëri që në vitin 2004 dhe po zhvilloheshin me shpejtësi. Dy procedura licencimi të shpallura nga autoriteti rregullator dështuan dhe operatorët ekzistues paraqitën pretendimin e tarifave të larta për licencim. Ky ligj u shndërrua shumë shpejt në një ligj të paaplikueshëm dhe lindi nevoja e një ligji të ri që do të integronte në një tekst të vetëm ligjin 8410/1998 dhe ligjin për transmetimet numerike.

Gjithsesi, ligji i vitit 2007 kishte një nen për kufizimet e pronësisë në media, neni 13 i ligjit, i cili kishte dhe titullin “Pluralizmi në median audiovizuale”.

Në bazë të këtij neni, një person juridik nuk mund të kishte më shumë se një licencë për një rrjet numerik tokësor. Një person fizik, që ka interesa ekonomikë ose është në pozitë vendimmarrëse në një person juridik që ka licencë për transmetim numerik tokësor, nuk mund të ketë interesa ekonomikë ose të jetë në pozitë vendimmarrëse në një person tjetër juridik që ka një licencë tjetër numerike tokësore. Një operator rrjeti kishte të drejtë të pajisej me licencë për transmetimin e një programi radioteleviziv dhe anasjellas. U jepej mundësia që, deri në vitin 2012 (afati maksimal i përcaktuar për kalimin në transmetimet numerike), operatorët analogë të mund të licencoheshin si operator rrjeti ose operator programesh. Për herë të parë u vendos kufizimi që asnjë operator i licencuar nuk mund të zotëronte më shumë se 30% të tregut të reklamave në tregun audiovizual. Ndërkohë, pronësia në personat juridikë që gëzojnë një licencë për operator rrjeti ose programi duhet të respektohte kriteret e përcaktuara në nenin 20 të ligjit 8410/1998.

⁷ Neni 22 i Ligjit

Për marrjen e vendimeve përkatëse për kufizimet e mësipërme, parashikohet që KKRT merrte mendimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës, në cdo rast që verifikonte lindjen e një situatë të tillë, do të njoftonte KKRT, e cila do të vendoste pezullimin ose heqjen e licencës. Ky nen parashikonte që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës ishte i detyrueshëm për KKRT-në.

Sic del qartë, pavarësisht qëllimit të ligjvënës, ky nen lë vend për interpretime e keqkuptime. Është i paqartë formulimi “person fizik që ka interesa ekonomike...” duke lënë vend për interpretime të shumta dhe duke moszgjdhur çështjen e familjarëve të përfshirë, si një situatë që verifikohet në praktikën shqiptare. Ndërkohë, raporti KKRT/Autoriteti i Konkurrencës është i paqartë. Nga njëra anë parashikohet marrja e mendimit të Autoritetit të konkurrencës nga KKRT, nga ana tjetër, parashikohet që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës është i detyrueshëm për KKRT.

Gjithsesi, nuk ka pasur asnjë zbatim në praktikë të këtij neni, sepse vetë ligji mbeti i pazbatueshëm në praktikë.

2. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

A. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, i miratuar me konsensus për përmbajtjen e tij në mars 2013, ka rregullim të qartë e të thjeshtë ligjor për çështjen e pronësisë në median audiovizive, në ndryshim nga rregullimet ligjore të mëparshme. Ky rregullim parashikohet në nenin 62 të ligjit.

Konkretisht ai parashikon se:

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio (radio) dhe audioviziv (televiziv) u jep vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në RSH, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare.
3. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një shoqëri të tretë kombëtare.
4. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv. Përsa i përket transmetimeve audiovizive, ligji bën

dallimin mes dy llojeve të licencave: licenca transmetimi që përshin licencë për rrjetin dhe si operator programi dhe licencë për shërbimin e programit audioviziv.

Përsa u përket licencave lokale apo rajonale të transmetimit audio dhe audioviziv, këto licenca u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

1. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.
2. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.
3. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale.
4. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv të mbështetura në rrjete satelitore.

Pika 10 e nenit 62 rregullon “fiktivitetin” e hasur në praktikë nga rregullimet ligjore të mëparshme. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. Për të mos lënë vend për interpretime të shumta, gjykoj se formulimi më i saktë do të ishte “..... dhe bashkëshorti, bashkëjetuesi dhe personat në lidhje gjinie apo krushqie me të deri në shkallë të dytë”. Gjithsesi, ky formulim shpreh qartë qëllimin e ligjvënës: aksionar do të konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat familjarë të afërt me të deri në shkallë të dytë dhe kufizimi prek gjithë rrethin e këtyre personave të marrë së bashku.

Në këndvështrim të ekuilibrit të interesave, tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës: (i) nevoja; (ii) domosdoshmëria, (iii) përshtatshmëria, i imponojnë ligjvënës të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në kufizimin e aksioneve në kapitalin e përgjithshëm për personat fizikë ose juridikë, aksionarë në shoqëri mbajtëse të licencave kombëtare të transmetimeve audiovizuale, si

ndërhyrje në lirinë ekonomike. Domosdoshmëria e detyron ligjvënësin të vërtetojë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera dhe se ka përdorur mjetin më pak të dëmshëm për subjektet që u kufizohet liria ekonomike. Ndërsa, përshtatshmëria e detyron ligjvënësin të argumentojë se mjeti i ndërhyrjes është efikas dhe ka sjellë efektet e pritshme dhe të dëshiruara në praktikë.

Pika 12 e nenit përmban dhe një kufizim tjetër të rëndësishëm: Asnjë zotërues i licencave kombëtare të transmetimeve përfshirë operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. Për këtë kontroll, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) duhet të miratojë aktet përkatëse nënligjore.

Një tjetër aspekt që garanton pluralizmin dhe konkurrencën e ndershme, është dhe përcaktimi ligjor mbi shfrytëzimin e multipleksit, parashikuar nga neni 63 i ligjit.

Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.

Në cdo rast, një subjekt i licencuar për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatëse lokale, rajonale dhe kombëtare.

Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, dhe në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, palët i drejtohen AMA-s. AMA, duke mbajtur parasysh garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues për OSHMA-të, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, pasi dëgjon pretendimet e palëve, vendos për

zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kundër vendimit të AMA-s, palët mund të bëjnë ankim në gjykatë.

Neni 62 dhe 63 i ligjit rregullojnë në mënyrë të qartë e të thjeshtë çështjen e kufizimit të pronësisë në median audiovizive dhe çështje që lidhen drejtpërdrejt me konceptin e gjerë të pluralizmit në media.

B. AMA, më datë 16 prill 2015 ka shpallur vendimin “Për çeljen e procedurës së dhënies së 5 (pesë) licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas “Beauty Contest”. Në procedurën “beauty contest” janë ftuar të marrin pjesë, në kuptim të ligjit, operatorët analogë historikë kombëtarë dhe operatorët ekzistues me eksperiencë në transmetimet numerike. “Privilegji” i këtyre operatorëve për të mos iu nënshtruar një konkurrencë të hapur parashikohet në dispozitat kalimtare të ligjit⁸ për gjithë periudhën e tranzicionit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike deri në datën 17 qershor 2015. Vendimi i AMAs ka disa shkelje ligjore, por përse i përket kufizimeve të pronësisë 4 nga 5 subjektet e ftuara për marrjen e një licence kombëtare transmetimi janë në shkelje të parashikimeve ligjore të nenit 62 të ligjit. Nëse një licencim i tillë do të vendosej nga AMA, do të ishim përballë një shkelje flagrante të ligjit dhe krijimit të një monopoli të pastër, në kundërshtim të plotë me parimin e pluralizmit në media⁹.

Konkluzione

Këshilli i Europës, në Rekomandim n.R (99) 1 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për masat për të promovuar pluralizmin në media, 19 janar 1999, ka dhënë disa alternative për rregullimin e pronësisë në media. Kështu, Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë hartimin e legjislacionit për të parandaluar ose luftuar përqendrime që mund të rrezikojnë pluralizmin e medias në nivel kombëtar, rajonal ose nivelet lokale, apo të shqyrtojnë mundësinë e përcaktimit të pragut ligjor në procedurat e licencimit apo autorizimeve, për të kufizuar ndikim që një kompani e vetme apo grup personash të zotërojnë një ose më shumë sektorë të medias, apo mund të parashikojnë kufizime përse i përket përqindjes së aksioneve në kompanitë mediatike. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të marrin në konsideratë adoptimin e masave specifike ku, ajo që quhet integrimi vertikal, që është kontrolli i elementeve si prodhimi, transmetimi, shpërndarja nga një kompani e vetme apo grup, të mos kthehet në rrezik për pluralizmin.

⁸ Nenet 138, 139 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

⁹ Pikërisht në këtë periudhë, një deputet i mazhorancës parlamentare depozitoi një projektligj për shfuqizimin e neni 62 të ligjit 97/2013, me argumentimin se ky nen pengon konkurrencën në treg. Ky propozim u prit me kritika të ashpra nga përfaqësuesit e OSBE dhe KiE dhe aktualisht pritet një ekspertizë për çështjen nga këto institucione.

Në përgjithësi, që nga ligji i parë i vitit 1997 e deri me ligjin e fundit, ligjvënësi shqiptar është kujdesur që të respektojë këto rekomandime, duke adoptuar formën e kufizimit të aksioneve brenda shoqërisë që mban një licencë audiovizive apo kufizime të tjera për licenca të dyta audio ose audiovizive. Pranohet gjerësisht që për vende me demokraci të brishtë si Shqipëria, pasja e rregullave të thjeshta e të qarta, që nuk lënë shumë vend për interpretim e për pasojë abuzim, është rruga më e mirë për të garantuar konkurrencën në tregun mediatik audioviziv. Deri në vitin 2013, rregullimi ligjor i çështjes ka ndjekur këtë rrugë, edhe pse me mangësi e të meta. Vështirë të mendohej në vitin 1997 që tregu audioviziv do të sundohej nga paligjshmëria për rreth 18 vjet.

Pas një pune rreth 6 vjeçare për ligjin e ri të medias, çështja më në fund gjeti rregullim të plotë në nenin 62 të Ligjit 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Dhe pikërisht kur mendohej që ky ligj, i përafuar tërësisht me direktivat dhe standardet evropiane, tashmë do të vendoste rregullat në një treg krejtësisht informal, propozimi (i një deputeti) për të shfuqizuar nenin 62, rrezikonte që jo vetëm ta kthente këtë ligj në të pazbatueshëm, të krijojë monopol në tregun mediatik, por edhe të rrezikojë vetë standardet demokratike.

Në vendimin e saj nr.56, datë 27.07.2016, Gjykata jonë Kushtetuese çmoi se pavarësisht rëndësisë së objektivit të ligjvënësit dhe pranisë së interesit publik për një sistem mediatik mbështetur thelbësisht në shumëllojshmërinë e informacionit, bazuar në kërkesën kushtetuese për ndërhyrje legislative proporcionale, masa kufizuese e parashikuar në nenin 62/3 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nuk i shërben ligjvënësit për të përmbushur efektivisht objektivin e përcaktuar dhe në këtë kuptim është mjet i papërshtatshëm dhe i panevojshëm. Si përfundim, Gjykata Kushtetuese çmoi se mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi për kufizimin e aksioneve të pronësisë së shoqërive që veprojnë në fushën e medias, nuk ka një lidhje të arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ligjvënësit për shumëllojshmëri informacioni. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ndërhyrja e ligjvënësit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, prandaj paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit për median u shfuqizua. Ajo që lind si nevojë tashmë pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese është detyrimi i ligjvënësit për të bërë amendimet e nevojshme në këtë ligj.

Bibliografi

- Ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”
 Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.
 Ligji nr.9742, datë 28.5. 2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
 Vendimi Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
 Vendimi nr.16, datë 11.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
 Vendimi *Europa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*, vendim i datës 7 qershor 2012.
 Vendimi *Informationsverein Lentia vs. Austri*, 14 Nëntor 1993.
 Këshilli i Europës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr.(2007) 2 “Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike”.
 Këshilli i Europës, Rekomandim i Komitetit të Ministrave Nr (1999) 1 “Për masat për të promovuar pluralizmin në media”, 19 janar 1999.
 V. Franceschelli, E. Tosi, “Diritto degli audiovisivi”, Giuffrè Editore, Milano, 2012.